



Planuar / Dorezuar Primijsno/Prodato Received/Delivery	26.05	2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Hr Prot Prot No	Shitja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKMSTHC	3063/2022		113	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.421/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.421/2022 të datës 26.04.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit/Komuna e Podujevës, në çështjen juridike “kontestim konkursi” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 26.05.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.421/2022 të datës 26.04.2022 të parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi me datë 26.04.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 14.04.2022 lidhur me Konkursin Nr.13/111/01-0005685/22 të datës 25.01.2022 të shpallur nga Komuna e Podujevës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 2401/2022 të datës 26.04.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-malin zyrtar të datës 29.04.2022 të Këshillit drejtuar Komunës së Podujevës; Përgjigjen e Komunës së Podujevës përmes e-mailit të datës 29.04.2022; Konkursin me Nr.13-111/01-0005685/22 të datës 25.01.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat materiale lidhur me çështjen, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi **SEPSE:**

Sipas vlerësimit të shkresave të lëndës rezulton se ankuesi ka aplikuar në Konkursin me Nr.13/111/01-0005685/22 të datës 25.01.2022, të shpallur nga Drejtoria e Administratës-në Komunën e Podujevës për pozitën e punës *Roje Objekti*. Ankuesi i pakënaqur me mos përzgjedhjen e tij, më datë 06.04.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa të Komunës së Podujevës, ndërsa kundër vendimit të këtij të fundi ankuesi parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në kuptim të pranushmërisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtar Publik përkatësisht nenit 2 ku përcaktohet se 3. *Nëpunës Civil- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë. 6. Nëpunës administrativo-teknik- dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike”, dhe si rrjedhojë ka konstatuar së pozita roje objekti hynë në kategorinë e nëpunësve administrativo teknik dhe mbështetës, gjegjësisht nuk është pozitë e shërbimit civil, andaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ku përcaktohet së Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidateve për pranim në Shërbim Civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.421/2022 të datës 26.04.2022 të parashtruar nga ankuesi*

Marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës është trajtuar në pjesën VII të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht neni 79 paragrafi 2 i këtij ligji, ka përcaktuar që: *Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të Ligjit, marrëdhënia e punës ndërmjet institucionit dhe nëpunësit administrativ dhe mbështetës rregullohet me legjislacionin e punës”, po mbi këtë bazë ligjore edhe bërë edhe shpallja e Konkursit me Nr.13-111/01-0005685/22 të datës 25.01.2022, kështu që në kuptim të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rrjedhë se zyrtarët publikë me status të nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në Gjykatën kompetente.*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.421/2022

Ilire Mehmeti Shaqiri

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Podujevës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

